



Republika e Kosovës * Republika Kosova * Republic of Kosovo

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



Në pajtim me nenin 62 paragrafi 6, i Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, neni 65 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit si dhe Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, Bordi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në mbledhjen e mbajtur me datë 29.09.2015 nxjerr këtë :

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 01/2015

P Ë R

NDARJEN E SUBVENCIONEVE

Neni 1.

Qëllimi

1. Ky udhëzim administrativ ka për qëllim të rregullojë funksionimin dhe veprimtarinë e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (në tekstin e mëposhtëm KPMM), përkatësisht caktimin e kriterëve rreth ndarjes së mjeteve nga buxheti i KPMM-së, i fondeve që janë të përcaktuara si subvencione.
2. Mjetet buxhetore nga pozicioni i subvencioneve do të shfrytëzohen nga përfituesit, që i plotësojnë kriteret e caktuara nga ky udhëzim administrativ, përkatësisht KPMM-ja do ta ketë një pasqyrë të qartë në lidhje me dhënien e mjeteve financiare, me ç ‘rast do të caktohen pos fushave edhe detajet tjera se për çfarë qëllimi do të ndahen këto mjete.
3. Ky udhëzim administrativ, do t’i shërbejë KPMM-së, për ndarjen e buxhetit nga pozicioni i subvencioneve në bazë të rregullave dhe kriterëve të qëndrueshme dhe stimuluese mbi të cilat do të bazohet ndarja e buxhetit të paraparë për subvencione.

Neni 2

Të drejtë për subvencion

Të drejtë subvencionimi kanë personat juridik, të cilët kanë nevojë dhe të cilët i plotësojnë kriteret për dhënie të subvencioneve.

Neni 3

Kërkesat

1. Personi që bënë kërkesë për përfitimin e subvencionit duhet t’i plotësoj këto kushte:
 1. Kërkesa me shkrim drejtuar KPMM-së.

2. Emrin dhe mbiemrin e tij apo emrin dhe mbiemrin i pronareve të shoqërisë ose organizatës jo qeveritare dhe të gjithat të dhënat e personit juridik apo OJQ-së.
3. Adresën zyrtare të aplikuesit apo personit juridik në Kosovë.
4. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës apo person juridik i regjistruar në Republikën e Kosovës.
5. Një përshkrim ku tregohen qëllimi i aplikimit, dhe përshkrimi i planit lidhur me projektin apo hulumtimin që aplikon për përfitim të subvencionit.

Neni 4

Kriteret e ndarjes se subvencioneve

1. Përfitues i subvencionit mund të jetë personi juridik ose organizatë jo qeveritare (OJQ) që bën kërkesë dhe që ka një plan projekt konkret të propozuar nga vet pala që aplikon për subvencion apo plan të propozuar nga KPMM-ja që do ti shërbej interesit të përgjithshëm dhe është në përputhje me strategjinë dhe politikat e KPMM-së.

Neni 5

Buxheti për subvencione

1. Subvencionet varen nga buxheti i dedikuar për subvencione sipas ndarjes buxhetore.
2. Buxheti për subvencionet është i limituar.

Neni 6

Vendosja dhe mënyra e votimit

1. Lidhur me përfituesit e subvencionit vendos Bordi i KPMM-së në përputhje me autorizimet që i ka në bazë të ligjit.

Neni 7

Obligimet e përfituesit të subvencionit

1. Përfituesi i subvencionit është i obliguar fondet e parapara si subvencion do ti shfrytëzoj për qëllimin e paraparë me kërkesë dhe me vendim të KPMM-së.
2. Që pas përfundimit të projektit të dorëzoj në KPMM **raportin e punës, apo hulumtimin** me të cilin dëshmohet përmbushja e planit apo (hulumtimit) të paraparë në bazë të vendimit për subvencion.

Neni 8
Ndarja e subvencionit

3. Ndarja e subvencionit bëhet në dy faza:

- 1.1 Fazën e parë menjëherë pas hyrjes në fuqi të vendimit lidhur me subvencionin e që përfshin 30 % të shumës totale të subvencionit dhe,
- 1.2 Fazën e dytë fazën pas përfundimit të projektit dhe dorëzimit të raportit me të cilin dëshmohet përmbushja e planit dhe projektit për të cilin pala ka fituar subvencionin e që përfshin pjesën tjetër të subvencionit.
- 1.3 Në rast se përfituesi i subvencionit nuk i përmbush detyrimet nga plani i dorëzuar në KPMM me të cilin e ka fituar subvencionin, atëherë KPMM-ja do të inicion procedurë gjyqësore pranë Gjykatës Kompetente në përputhje me Ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës.

Neni 9
Ankesat

1. Aplikuesi të cilit i është refuzuar kërkesa për subvencion mund të paraqes ankesë me shkrim në afat 8 ditë pas pranimit të vendimit, duke iu drejtuar Komisionit të themeluar nga drejtori për këto raste .

Neni 10
Hyrja në fuqi

1. Ky udhëzim Administrativ hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në faqen e KPMM-së

